

NDËRLIDHJA NË MES TË PËRVOJAVE TRAUMATIKE, PËRKRAHJES
SOCIALE DHE MIRËQENIES PSIKOLOGJIKE TE FAMILJET E
DËSHMORËVE TË RËNË GJATË LUFTËS NË KOSOVË
STUDIM KUALITATIV

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

TRINGA VISOKA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM
PRISHTINË

QERSHOR, 2022

Ndërlidhja në mes të përvojave traumatike, përkrahjes sociale dhe mirëqenies psikologjike te familjet e dëshmorëve të rënë gjatë luftës në Kosovë

Tringa Visoka

Mentori: Aliriza Arënliu, Prof. Asoc. Dr.

Studimet e ndryshme mbi familjet e dëshmorëve flasin për përjetimet traumatike të familjarëve, duke përfshirë humbjen e më të dashurve të tyre, përjetimet emocionale dhe sfidat në të cilat hasin familjarët në fjalë. Studimi mbi përvojat traumatike, përkrahjen sociale dhe mirëqenien psikologjike te familjet e dëshmorëve të rënë gjatë luftës në Kosovë, është një ndër studimet i cili është realizuar me një mostër prej 15 grave të dëshmorëve të rënë në komunën e Podujevës. Ky hulumtim ka pasur për synim të njoh një perspektivë tjetër rreth përjetimeve të grave të dëshmorëve, duke u fokusuar në tri periudhat: para luftës, përgjatë luftës dhe pas luftës në Kosovë. Gratë e përzgjedhura për intervistim kanë diskutuar rreth përkrahjes sociale dhe përkrahjes së marrë nga institucionet e vendit tonë.

Rrjedhimisht, janë zhvilluar intervistat gjysmë të strukturuar me mostrën përkatëse, intervista të cilat kanë pasur për qëllim që të njohin gjendjen psikologjike dhe atë emocionale të grave të intervistuar. Lidhur me hulumtimin e realizuar, janë parashtruar tri pyetje hulumtuese, të cilat kanë vijuar me rezultatet e përshkruara si në vijim:

1. Cilat janë burimet e përkrahjes për ballafaqimin me vështirësitë emocionale, ekonomike dhe sociale?
2. Cilat janë nevojat kryesore të mbështetjes psikologjike dhe sociale të familjarëve të dëshmorëve?

3. Si arrijnë të menaxhojnë situatat stresuese, familjet e dëshmorëve?

Burimet e përkrahjes për ballafaqimin me vështirësitë emocionale, ekonomike dhe sociale:

Lidhur me burimet e përkrahjes për ballafaqimin me vështirësitë emocionale, ekonomike dhe sociale, të intervistuarat kanë deklaruar se ndër burimet e përkrahjes që kanë ndihmuar në tejkalimin e vështirësive të tyre ka qenë përkrahja e marrë nga familja. Gratë e intervistuarat kanë pohuar se humbja e bashkëshortit ka ndikuar që ato të përballen me vështirësi nga më të ndryshmet. Si rrjedhojë, ato kanë marrë përkrahje nga familjarët duke përfshirë, prindërit, vëllezërit dhe motrat. Gjithashtu, gratë e dëshmorëve kanë pohuar se ato kanë gëzuar përkrahje morale dhe financiare edhe nga familja e bashkëshortit. Kësisoj, ato kanë marrë ndihmë në situata të ndryshme, qoftë për nga ana financiare apo për edukimin e fëmijëve të tyre.

Nevojat kryesore të mbështetjes psikologjike dhe sociale të familjarëve të dëshmorëve:

Ndërsa, sa i përket nevojave kryesore të mbështetjes psikologjike dhe sociale të gratë e dëshmorëve të rënë në komunën e Podujevës, gratë kanë potencuar se ato hasin në nevoja nga më të ndryshmet, duke përfshirë: nevojat financiare, nevojat për përkrahje institucionale dhe nevojën për marrjen e shërbimeve nga një profesionist i shëndetit mendor. Përgjatë intervistimit, gratë e intervistuarat kanë pohuar se shumë nga ato kanë hasur edhe në vështirësi financiare, megjithatë përkrahja e marrë nga familjarët, ka ndihmuar që ato të tejkalojnë vështirësitë e hasura në këtë aspekt. Së dyti, përgjatë intervistave, gratë kanë potencuar se institucionet lokale dhe ato vendore nuk kanë dhënë përkrahje të mjaftueshme për familjet e dëshmorëve në komunën e Podujevës. Si rrjedhojë, gratë hasin në nevojën për përkrahje më të madhe nga institucionet. Përgjatë intervistave, të intervistuarat kanë deklaruar se ato hasin në nevojën e marrjes së shërbimeve psikologjike nga një profesionist i shëndetit mendor. Përjetimet përgjatë periudhës së luftës dhe humbja e bashkëshortit

kanë ndikuar që ato të përballen me shumë vështirësi në jetën e tyre. Ky fakt padyshim që, ka hasur në nevojën e grave për t'u konsultuar me profesionistë të shëndetit mendor.

Menaxhimi i situatave stresuese:

Përjetimet e grave të dëshmorëve në komunën e Podujevës përgjatë luftës së fundit në Kosovë, ka ndikuar që gratë të raportojnë një nivel të dukshëm të stresit. Përgjatë intervistimit, shumë nga gratë kanë pohuar se të gjitha këto përjetime nuk kanë qenë aspak të lehta për t'u përballuar. Të intervistuarat kanë potencuar se ato kanë përballuar përjetime nga më të ndryshme duke përfshirë: sfidat në lidhje me edukimin e fëmijëve, paragjykimet nga shoqëria dhe mungesa e përkrahjes nga institucionet vendore. Megjithatë, gratë kanë arritur që të menaxhojnë situatat e ndryshme stresuese duke përdorur disa mekanizma të cilët janë: aspekti religjioz dhe mbështetja te fëmijët.

Kur ndalemi te ana religjioze, gratë e dëshmorëve në komunën e Podujevës kanë potencuar që, praktikimi i riteve fetare ka ndihmuar që ato të ndihen më mirë emocionalisht. Rrjedhimisht, të intervistuarat kanë deklaruar që ato praktikojnë rite islame, të cilat ndikojnë që gratë të lirojnë ankthin dhe dhimbjen e përjetuar si rrjedhojë e përjetimeve paraprake. Shembull, shumë nga të intervistuarat kanë potencuar se ato falin Namaz, lexojnë Kuran dhe praktikojnë derse të ndryshme fetare. Në përgjigjet e dhëna, shumë nga të intervistuarat kanë pohuar se, forca më e madhe që ju ka ndihmuar atyre për të tejkaluar këto sfida, ka qenë besimi në Zot. Kësisoj, gratë kanë arritur që të menaxhojnë situata të ndryshme të cilat kanë krijuar stres te ato.

Së dyti, një ndër mekanizmat që ka ndihmuar gratë e dëshmorëve që të tejkalojnë situatat stresuese, ka qenë mbështetja te fëmijët. Në shumicën e përgjigjeve të dhëna, gratë kanë deklaruar se ato marrin forcë nga fëmijët e tyre. Gjithashtu, shumë nga të intervistuarat kanë pohuar se, fëmijët janë shtylla e tyre dhe se nëse ato nuk do të kishin fëmijë, do ta kishin shumë më të vështirë që të tejkalonin sfidat e tyre.

Nga të gjitha faktet e lartpërmendura, studimi në fjalë ka arritur që të nxjerr në pah histori dhe përjetime nga më të ndryshme të familjeve të dëshmorëve në komunën e Podujevës. Ky studim ka treguar edhe njëherë tjetër për forcën dhe kurajon që kanë gratë e vendit tonë.